



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS  
KESHILLI BASHKIAK**

Nr 24 Prot

Vau Dejës, me 04 / 01 / 2019

**VENDIM**

**NR. 88 DATE 24.12.2019**

**Për miratim,**

**Për shtesë shtesë të VKM 1423 datë 10.10.2008 “Për miratimin e listës perfundimtare të pronave të paluajtshme publike e shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkise Vau Dejës” te Qarkut Shkoder.**

Me propozim të Kryetarit të Bashkise në zbatim të ligjit 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ndryshuar, Neni 64 pika (c), si dhe neni 8 “Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor”, Neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.2. Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë: a) njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; ç) e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës, i cili nuk mund t’ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër. Neni 15 “Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore”, Neni “Konsultimi publik në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, Neni 18 “Seancat e këshillimeve me bashkësinë”, pika 1. Këshilli bashkiak ose këshilli i qarkut, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë, të cilat janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenet 54, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, dhe 77, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, të këtij ligji.

Ligji nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar.

Ligji nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

Udhëzimi nr.1, datë 15.02.2002 “Për plotësimin e formularit për inventarizimin dhe transferimin e ambjenteve administrative në pronësi të njësive të qeverisjes vendore”

Udhëzimi nr.2, datë 30.04.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit dhe plotësimin e formularëve”.

Udhëzimi nr.3, datë 18.07.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”.

Udhëzimi nr.15, datë 30.05.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”.

VKM nr.1423 dt.10.10.2008 “Për miratimin e listës perfundimtare të pronave të paluajtshme publike e shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkise Vau Dejës” te Qarkut Shkoder. në ligjin Nr.111/2018 date 21.03.2019 “Për Kadastrën”. Si dhe mbeshtetur në ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, 55, ndryshuar.

**Këshilli Bashkiak, pas diskutimit dhe miratimit me shumicë të cilesuar të votave,**